

23 mars 2026,
Prishtinë

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË PUNËS DHE STATUTAR TË FBK-SË I DATËS 23 MARS 2026

1. HYRJE

Kuvendi i Punës dhe Statutar i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) u mbajt me 23 mars 2026 në Hotel Hotel Courtyard by Marriott, Prishtinë. Kuvendi filloi në orën 17:30 i kryesuar nga Kryetari i FBK-së, z. Arben Fetahu në prani të Sekretares së Përgjithshme të FBK-së, znj. Elvira Dushku.

Kryetari Fetahu përshëndeti delegatët dhe mysafirët e pranishëm, falënderoi të gjithë për pjesëmarrjen dhe shpalli të hapur punimet e Kuvendit.

2. ZGJEDHJA E TRUPAVE PUNUES TË KUVENDIT DHE KONSTATIMI I KUORUMIT

Në vazhdim, konform rendit të ditës, me propozim të Kryetarit Fetahu dhe me votim unanim u zgjedhën trupat punues të Kuvendit me këtë përbërje:

- Kryesia e Punës: z. Arben Fetahu, znj. Linda Shala, dhe z. Liridon Gashi.
- Komisioni Verifikues: znj. Teuta Abdullahu, z. Izet Tahiri, z. Xhelil Gashi.
- Procesmbajtësi: z. Albert Sylejmani.

Komisioni Verifikues, përfaqësuar nga z. Izet Tahiri, konstatoi kuorum të mjaftueshëm për vazhdimin e punimeve, me 33 nga 37 delegatë me të drejtë vote të pranishëm.

3. RAPORTI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Në vazhdim fjalën e mori anëtari i Këshillit Mbikëqyrës të FBK-së, z. Leart Hoxha, i cili prezantoi gjetjet e Këshillit, duke potencuar 3 tema kryesore:

Tema I – Propozim-ndryshimet statutare: Sa i përket rritjes së numrit të anëtarëve të Bordit të FBK-së, ai sqaroi se për të respektuar disa parime të barazisë gjinore, të cilat e karakterizojnë FBK-në, ishte vendosur të përfshihen jo një, por dy sportistë aktivë, një nga secila gjini, sipas specifikimeve të dokumenteve përkatëse. Ndërsa, në lidhje me kufizimin e mandateve, ligji i ri për sportin nuk kufizon më numrin e mandateve dhe nuk i lidh ato me ciklin olimpik, siç ndodhte më parë, kur mandatet lidhnin pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë Verore. Statuti parashikon që vendimet e këtij kuvendi janë krejtësisht legjitime nëse aprovohen me dy të tretat e votave të pranishme, pa shkelur ligjin, dhe nuk mund të kontestohen nga jashtë apo nga cilido tjetër.

AS

Tema II – Borxhet dhe disiplina financiare: U theksua se ekzistojnë dy fenomene të financave në këtë analizë të borxheve. Së pari, borxhet që klubet i kanë federatës, të cilat janë shqetësuese dhe tregojnë se disa klube funksionojnë në mënyrë të çrregullt, duke i dalë situatës nga kontrolli. FBK duhet të punojë ngushtë me klubet për të shmangur situata ku klubet e mëdha, për shkak të borxheve të mëdha, mund të shpallin falimentimin dhe të humbasin traditën dhe historinë e tyre. Federata duhet të insistoje në disiplinë financiare, përmes kushtëzimeve, vërtetimeve për sponsorizim dhe mos-licencimit të lojtarëve, për të siguruar që borxhet të paguhen. Një problem shtesë është vonesa në inkasimin e mjeteve nga institucionet publike, për shkak të situatës politike në vend. Gjithashtu, federata ka borxhe ndaj palëve të ndryshme, ku situata është gjithashtu sfiduese. Superliga, si produkti kryesor, sjell përfitime, por edhe shkakton shpenzime të mëdha, duke përfshirë pagesat për gjyqtarët, delegatët, Lledat, transmetimet, reklamat dhe marketingun.

Tema III – Strategjia e FBK-së 2026–2030: Hoxha rekomandoi që të punohet më intensivisht me strategjinë, duke e lexuar dhe duke u angazhuar në përkrahjen e saj. Ai theksoi se në strategjinë 2021–2025 vërehet një anomali: numri i klubeve është rritur, por numri i lojtarëve mbetet i njëjtë, pasi lojtarët e njëjtë ndryshojnë klube. E njëjta situatë vlen edhe për gjeneratat e reja. Nëse nuk ka kuantitet, është e vështirë të arrihet kualiteti. Klubet duhet të përqafojnë strategjinë e re dhe të punojnë në përputhje me të, por ky angazhim nuk imponon zyrat apo bordin e FBK-së, nëse nuk ka vullnet nga klubet. Ai përfundoi duke përgëzuar bordin për punën e deritanishme të realizuar.

Pas prezantimit të raportit të Këshillit Mbikëqyrës, delegati z. Fikret Shatri (KB Istogu) theksoi se në Kosovë tashmë ekzistojnë dy klube të shuara të Superligës për shkak të keqmenaxhimit, konkretisht Prishtina dhe Rahoveci, të cilat tani kanë emra të ndryshëm nga të kaluarat. Ai nënvizoi se as Federata e Basketbollit të Kosovës nuk është e imunizuar nga këto situata dhe duhet të jetë e kujdesshme për të shmangur përsëritjen e tyre.

Kryetar i FBK-së, vlerësoi raportin e Këshillit Mbikëqyrës duke e cilësuar si raportin më të thelluar dhe të detajuar financiar deri më tani. Ai vuri në dukje rëndësinë e qartësisë dhe transparencës në menaxhimin e financave të federatës. Më tej, Fetahu elaboroi situatën financiare duke sqaruar se FBK ka borxhe ndaj palëve të treta, ndërsa klubet kanë borxhe të vjetra me vlerë të konsiderueshme. Ai theksoi se borxhi më i madh është ndaj shtetit, veçanërisht ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Sa i përket Superligës, Fetahu shpjegoi se federata ka insistuar që borxhet të mblidhen përmes kushtëzimeve, duke bërë disa përjashtime të vogla, dhe është përpjekur të ruhet konkurrenca e drejtë mes klubeve.

Në përfundim, Raporti i Këshillit Mbikëqyrës u miratua me aklamacion.

A.S

4. MIRATIMI I RENDIT TË DITËS

Kryetari paraqiti rendin e ditës të propozuar për Kuvendin, pyeti delegatët për propozime për ndryshime, dhe delegatët e miratuan rendin e ditës pa asnjë vërejtje.

5. MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË KUVENDIT TË MËPARSHËM

Tutje, Kryetari i FBK-së, pyeti delegatët për miratimin apo jo të Procesverbalit nga Kuvendi i Punës dhe Statutar i mbajtur në Prishtinë me datë 31.01.2025. Delegatët miratuan procesverbalin në mënyrë unanime pa asnjë votë kundër apo abstenim.

6. RAPORTI I PUNËS, RAPORTI I AUDITORIT DHE PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE PËR VITIN 2025

Kryetari Fetahu prezantoi përmbledhjen e sukseseve dhe sfidave të vitit 2025, duke përfshirë rezultatet e U20 meshkuj dhe projektet ndërkombëtare që u zhvilluan gjatë vitit. Fetahu sqaroi se në Lojërat Mesdhetare 2030 Kosova do të përfaqësohet me ekipin 3x3.

Ai gjithashtu theksoi punën e vazhdueshme me të gjitha grupet e interesit dhe bashkëpunimin e ngushtë me sponsorët e FBK-së. Ai bëri të ditur se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) kishte përkrahur disa projekte të federatës, megjithatë përkrahja nuk ishte e plotë për shkak të fondeve më të pakta se sa ishte pritur, situatë kjo e ndikuar edhe nga numri i madh i zgjedhjeve në vend.

Fetahu njoftoi gjithashtu se stafi i federatës është kompletuar dhe se tash po rritet me përfshirjen e dy trajnerëve të rinj. Ai përmendi pjesëmarrjen e 11 ekipeve ndërkombëtare dhe falënderoi skuadrat që garuan në arenën ndërkombëtare për punën dhe angazhimin e tyre.

Ai potencoi se FBK ka organizuar 11 liga të kategorive të reja dhe përgëzoi veteranët e Kosovës për rezultatet e arritura. Fetahu përfundoi duke theksuar se rendi i ditës përfshinte përmendjen e kampionëve dhe fituesve të trofeve, si dhe njoftimin e kuvendarëve mbi arritjet individuale të stafit të federatës.

Sa i përket raportit financiar, Kryetari sqaroi se raporti i plotë financiar dhe i auditimit ishte dërguar paraprakisht të gjithë delegatët në mënyrë që ata të kishin mundësi ta shqyrtonin. Gjatë kuvendit, ai prezantoi një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore, duke përfshirë pasqyrën e borxheve, të hyrave dhe shpenzimeve.

Të gjithë raportet, përfshirë Raportin e Punës dhe pasqyrat financiare për vitin 2025, u miratuan unanimisht nga delegatët.

A.S

7. PLANI I VEPRIMIT 2026 & PLANI I MARKETINGUT DHE SHPËRNDARJES 2026

Znj. Elvira Dushku, Sekretare e Përgjithshme e FBK-së, prezantoi synimet dhe projektet kryesore të vitit 2026, të cilat janë pjesë edhe e strategjisë së përgjithshme 2026–2030. Ajo theksoi rëndësinë e zhvillimit të basketbollit në të gjitha nivelet, duke përfshirë: organizimin e turneve 3x3, promovimin e basketbollit në shkolla, avancimin dhe zhvillimin profesional të trajnerëve, si dhe identifikimin dhe mbështetjen e talenteve të reja.

Një pjesë tjetër thelbësore e planeve është digjitalizimi i klubeve, një proces që paraqet sfida për të gjithë, por federata do të mbështesë klubet për ta realizuar këtë fazë sa më mirë, duke ofruar asistencë dhe udhëzime për zbatimin e suksesshëm. Ajo gjithashtu nënvizoi rëndësinë e koordinimit të projekteve me grupet e interesit dhe sponsorët, në mënyrë që të maksimizohet ndikimi dhe të rritet cilësia e zhvillimit të basketbollit në Kosovë.

Të gjitha planet e prezantuara nga znj. Dushku u miratuan me aklamacion nga delegatët.

8. PLANI FINANCIAR 2026

Plani financiar për vitin 2026 u prezantua nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, e cila në pika të shkurtra paraqiti parashikimin për vitin 2026, duke përfshirë të hyrat, shpenzimet, si dhe mbështetjen financiare të klubeve dhe projekteve strategjike të federatës.

Më pas, z. Fatmir Gashi, nënkryetar i FBK-së, propozoi përfshirjen e deficitit në planin financiar dhe autorizimin e Bordit të FBK-së që të menaxhojë borxhin e mëhershëm, me qëllim që ai të reduktohet gradualisht gjatë viteve të ardhshme. Ai nënvizoi se për të arritur këtë objektiv, të gjithë delegatët dhe klubet duhet të kontribuojnë duke shlyer borxhet e tyre dhe duke siguruar mbështetje financiare për federatën. Z. Gashi theksoi gjithashtu se zhvillimi i sportistëve të rinj dhe i projekteve të reja nuk mund të realizohet vetëm me fjalë, por kërkon mbështetje konkrete financiare dhe planifikim të kujdesshëm.

Pas diskutimeve dhe pyetjeve nga delegatët, plani financiar për vitin 2026, duke përfshirë ndryshimet e propozuara nga z. Gashi, u miratua me aklamacion nga të gjithë delegatët.

9. PREZANTIMI DHE MIRA TIMI I PLANIT STRATEGJIK TË FBK-SË PËR PERIUdhËN 2026–2030

Kryetari Arben Fetahu bëri të ditur se dokumenti i strategjisë 2026–2030 ishte ndarë paraprakisht me të gjithë delegatët. Ai sqaroi se, për shkak të kohës së kufizuar të prezantimit gjatë kuvendit, do të përmbledhë vetëm pikat kryesore të strategjisë, duke përfshirë vizionin, misionin, vlerat dhe objektivat strategjike të federatës për periudhën 2026–2030.

A. S

Fetahu theksoi rëndësinë e kësaj strategjie si udhërrëfyes për zhvillimin e sportit dhe talenteve, për avancimin e gjeneratave të reja, për fuqizimin e trajnerëve dhe për promovimin e basketbollit në të gjitha nivelet. Ai nënvizoi gjithashtu që implementimi i strategjisë kërkon bashkëpunim të ngushtë me klubet, sponsorët dhe institucionet përkatëse, duke respektuar vullnetin dhe angazhimin e të gjithëve për arritjen e objektivave të planifikuara.

Pas prezantimit të përmbledhjes së pikave kryesore të strategjisë, delegatët diskutuan mbi çështje të ndryshme operative dhe infrastrukturore që ndikojnë në zhvillimin e basketbollit në Kosovë.

z. Fikret Shatri (KB Istogu) theksoi se problemet me infrastrukturën po shkaktojnë vështirësi të mëdha, ndërsa mungesa e përkrahjes nga komunat përkatëse e komplikon më tej situatën. Ai nënvizoi rëndësinë e rolit të komunave si aktorë kyç dhe se, kur nuk funksionon lidhja midis klubit – komunës – FBK-së – ministrisë – qeverisë, pasojat për sportin janë tejet serioze.

z. Izet Tahiri (KB Trepça) propozoi që të mendohet formimi i ligës U20 ose U21 për djemtë, duke theksuar se Superliga ka pak djem që realisht mund të përfshihen, ndërsa sistemi i propozuar duket se funksionon më mirë për vajzat tek Liga Zhvillimore U21. Kryetari Fetahu iu përgjigj se ri-formatizimi i garave do të merret parasysh dhe do të shqyrtohet në përputhje me nevojat e zhvillimit të lojtarëve të rinj.

z. Isa Prebreza (KB Kosovari) vuri në dukje se Liga I ka një numër të madh lojtarësh, por se niveli i lojës është i ulët dhe ka nevojë për më shumë përkrahje dhe mbështetje nga FBK-ja. Kryetari Fetahu shtoi se Liga I është pothuajse e vetmja ligë që merr kaq pak mbështetje financiare nga federata, por se kjo çështje do të merret parasysh dhe do të shqyrtohet për të përmirësuar zhvillimin e ligës dhe të lojtarëve.

Pas diskutimeve, Strategjia 2026-2030 u hodh në votim dhe u miratua me aklamacion.

10. NDRYSHIMET STATUTARE DHE NË AKTET TJERA NORMATIVE

Delegatëve u ishin dërguar paraprakisht të gjitha ndryshimet e propozuara, në mënyrë që ata të kishin mundësi t'i shqyrtonin me kohë para Kuvendit. Në këtë kuadër, Kryetari vendosi në votim ndryshimet e propozuara në:

1. Statutin e FBK-së,
2. Rregulloren e Punës së Kuvendit të FBK-së,
3. Rregulloren e Punës së Bordit të FBK-së,
4. Rregulloren e Punës së Këshillit Mbikëqyrës të FBK-së,
5. Rregulloren e Punës së Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së,

Të gjitha këto ndryshime u miratuan me aklamacion nga delegatët.

A.S

11. VOTIMI PËR ANËTARIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Kryetari informoi delegatët për dorëheqjen e z. Dren Zatriqi nga posti i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës. Në përputhje me Statutin e FBK-së, Kuvendi procedoi me votimin për përbërjen e re të Këshillit Mbikëqyrës, me përbërje:

- Leart Hoxha – Kryesues;
- Adelina Qipa – Anëtare; dhe
- Arbër Gorani – Anëtar (i ri).

Delegatët miratuan anëtarin e ri me aklamacion.

12. TË NDRYSHME

Kryetari pyeti delegatët nëse kishin ndonjë çështje tjetër për diskutim në kuadër të pikës “Të ndryshme”.

z. Fikret Shatri (KB Istogu) lidhi diskutimin me komentën e bërë më herët nga z. Isa Prebreza, duke theksuar se me kushtet aktuale të infrastrukturës dhe organizimit, realizimi i katër ndeshjeve vajtje-ardhje, si dhe inkuadrimi i KB Drita në Ligën I, mund të ketë pasoja negative për basketbollin në Kosovë. Ai shprehu shqetësimin e tij ndaj politikave *ad hoc* që ndikojnë në zhvillimin e garave dhe kërkoi sqarime nga FBK, në mënyrë që klubet të mbrohen dhe të respektohen rregullat e lojës dhe të garës. Ai gjithashtu ngriti çështjen e lojtarit Rrezon Elezaj, duke kërkuar që federata të japë mbrojtje për të gjitha klubet e saja.

MBYLLJA E KUVENDIT

Kryetari pyeti delegatët për komente të tjera. Duke mos pasur asgjë për të shtuar, ai falënderoi pjesëmarrësit dhe i ftoi në koktejin e organizuar.

Përgatiti:

Albert SYLEJMANI



Procesmbajtës

Miratoi:

Arben FETAHU



Kryetar

